



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

RAPORTI I PUNËS NGA DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në komunën e Podujevës, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural funksionin përmes një sektori:

➤ Sektor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Qëllimet kryesore të politikave bujqësore për vitin 2025 kanë qenë:

- *Kalimi nga prodhimtaria në ferma që plotësojnë nevojat e ekonomisë familjare në ferma gjysmë komerciale dhe komerciale;*
- *Zbutja e papunësisë, varfërisë dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës për banorët e zonave rurale.*

Objektivat e përgjithshme të DBPZHR për vitin 2025 kanë qenë:

- Edukimi i vazhdueshëm dhe përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural;
- Forcimi i zinxhirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi;
- Përfshirja sociale, zvogëlimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale;
- Mbështetja në aktivizimin e fermave, plantacioneve bujqësore si dhe kapaciteteve përpunuese ushqimore në komunën e Podujevës.


Fokusi kryesor janë investimet në fushat si:

1. Pemëtaria -pemët e imëta;
2. Perimtaria;
3. Blegtoria;
4. Bletaria;
5. Shpezëtaria;
6. Mekanizëm bujqësor.


Projektet të cilat janë realizuar gjatë vitit 2025, (realizuar përmes objektivave specifike në fushat përkatëse) janë:

N r.	Aktiviteti	Përshkrimi	Vlera e projektit €
1	“Përkrahja e fermerëve me fidane të mjedrës” 	Është bërë përkrahja e 10 fermerëve me fidane të mjedrës për implementimin e projektit, me nga 1100 euro vlerë monetare në formën e pagesave direkte. Qëllimi kryesor -Ngritja e pemishteve moderne me mjedër si dhe rritja e kapaciteteve prodhuese në sektorin e pemëve të imëta që janë strategjike për komunën tonë.	

2	“Përkrahja e fermerëve me fidane të feferonave” 	Është bërë përzgjedhja e 15 fermerëve për implementimin e projektit, të cilët janë mbështetur me nga 700 euro vlerë monetare në formën e pagesave direkte. Thirrja ka qenë e hapur nga data 16.01.2025 deri më 05.02.2025. Qëllimi kryesor – Mbështetja e fermerëve dhe rritja e sipërfaqeve të mbjellura me perimkulturë.	
3	“Furnizim me pajisje për pemëtari”	Gjatë këtij viti janë përkrahur 43 fermer me dy lloje të pajisje për pemëtari. Ftesa publike ka qenë e hapur nga data 02.04.2025 deri më 24.04.2025. Qëllimi kryesor - Rritja e rendimentit dhe cilësisë së frutave në pemishte.	

4	“Furnizimi dhe montimi i serrave për fermerë” 	Në fushën e perimtarisë do të mbështeten rreth 149 fermer me serra të këtyre madhësive: 50 m²; 500 m² dhe 1000 m². Ftesa publike ka qenë e hapur nga data 07.11.2025 deri më 27.11.2025. Projekti është në fazën e vlerësimit të kërkesave të fermerëve. Në këtë mënyrë planifikohet të kontribohet në përmirësimin e kushteve të punës së tyre, duke krijuar kushte për gjenerim të të hyrave më të mëdha dhe vetëpunësim nga aktivitetet e tyre. Qëllimi kryesor- Ngritje të kapaciteteve të kultivimit të perimeve në ambiente të mbyllura (serra).	
5	“Furnizimi me mekanizëm bujqësor”	Gjatë këtij viti janë përkrahura rreth 143 fermer me disa lloje të mekanizmit bujqësor të ndara në dy lote. Qëllimi kryesor- Rritja e kapaciteteve prodhuese të kulturave bujqësore përmes përgatitjes më cilësore të tokës.	

6	“Subvencione për blegtori” 	Gjatë këtij viti gjithsej 174 fermer janë përkrahur në sektorin e blegtorisë. Prej tyre 10 fermer janë përkrahur me Laktofriz 300 lt dhe 5 fermer me Mikser për ushqim voluminoz 2m³. Gjithashtu ka qenë e hapur ftesa publike për 162 mëshqerra nga data 31.10.2025 deri më 20.11.2025, deri më tani është publikuar lista përfundimtare e fermerëve përfitues, si dhe pritët të bëhet shpërndarja e mëshqerrave. Qëllimi kryesor- mbështetja e fermerëve në avancimin dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese si dhe rritjen e numrit gjedheve.	
7	“Subvencione për bletari- Përkrahja me pasije për bletari” 	Gjatë këtij viti në sektorin e bletarisë, kanë përfituar 15 fermer, të cilët janë përkrahur me pajisje për bletari. Qëllimi kryesor- mbështetja e bletarëve në rritjen e kapaciteteve prodhuese të mjalitit dhe shtimin e numrit të bletëve	

8	“Subvencione për shpeztari” 	Këtë vit në kaudër të projekteve të është vendosur edhe sektori i shpeztarisë. Në kuadër të këtij projekti janë përkrahur 3 fermer me printer automatik për vulosjen e vezëve. Qëllimi kryesor- Përkrahje e fermerëve në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin e shpeztarisë.	
	“Ndërtimi i parku bujqësor industrial në Sfeqël” 	Ky projekt në vlerë prej 1.4 milionë euro ka nisur të ndërtohet sot në fshatin Sfeqël. Ky park bujqësor do të shtrihet në një sipërfaqe prej 6 hektarësh, ku do të ndërtohen serra me madhësi të ndryshme për kultivimin e kulturave të llojllojshme bujqësore, duke krijuar kushte moderne për prodhim, zhvillim dhe inovacion në sektorin bujqësor. Ky project është në realizim e sipër, në bashkëpunim me Organizatën “Qatar Charity”.	

“Ndërtimin e kanalit të ujitjes së tokave bujqësore në fshatin Lupç i Poshtëm” 	Ky projekt, me vlerë rreth 110 mijë euro, do të mundësojë ujitjen e afërsisht 80 hektarëve tokë bujqësore, duke ndihmuar drejtpërdrejt fermerët e zonës në rritjen e prodhimit dhe efikasitetit të punës së tyre.
--	--

Projektet e realizuara në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë vitit 2025:

DBPZHR bazuar në kriteret e MBPZHR-së është e angazhuar në mbështetjen e fermerëve të komunës së Podujevës në përgatitjen e dokumentacionit të duhur për aplikimin e tyre në këto skema si dhe në përcjelljen e tyre në MBPZHR për shqyrtim dhe miratim. Ky aktivitet është duke u zbatuar dhe është i ndarë sipas thirrjeve të MBPZHR-se për sektorët përkatës.

- **THIRRJE PËR APLIKIM- Për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therrjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e dytë 2024-** Kjo thirrje ka qenë e hapur nga data 15.01.2025 dhe ka mbaruar më 13.02.2025. Në kuadër të kësaj thirrje janë pranuar gjithsej **85 aplikime** të fermerëve për qumësht sipas cilësisë dhe **9 aplikime** për viça sipas majmërisë të cilat pas përfundimit të afatit janë dërguar për shqyrtim dhe miratim në MBPZHR.

- **THIRRJE PËR APLIKIM- Për mbështetje përmes Programit për Pagesa Direkte për kulturat dhe aktivitetet bujqësore për vitin 2024-** Kjo thirrje nga MBPZHR ka qenë e hapur nga data 3.04.2024 deri me datë 19.05.2025 në ora 16:00, gjithsej gjatë kësaj periudhe janë pranuar 2253 aplikacione të fermerëve të janë proceduar për shqyrtim dhe miratim në MBPZHR. Një pjesë e të cilave pagesa është realizuar, ndërsa pjesa tjetër është duke u verifikuar në terren.

- **THIRRJE PËR APLIKIM** – për qumësht/litër, therrjet e raportuara të gjedhit dhe grumbullimin (tërheqjen dhe pranimin) dhe përpunimin e nënprodukteve shtazore-mbetjeve, viçat për majmëri, zogjët për majmëri (brojlerët), akuakulturë dhe sasinë e dorzuar të grurit ashtu siq parashihet me programin e Pagesave Direkte 2025. - Kjo thirrje ka qenë hapur nga data: 01.08.2025 - 25.9.2025, aplikacionet e fermerëve janë dërguar për shqyrtim dhe miratim në MBPZHR ku ka filluar shqyrtimi i tyre. Në këtë thirrje kanë aplikuar 734 fermer.
- **THIRRJE PËR APLIKIM- Pagesa direkte për kilogramët e shitur të mjedrës** - Kjo thirrje është hapur më datë 1.9.2025 dhe vazhdon të jetë e hapur deri me 15.12.2025. Deri më tani janë pranuar 141 aplikime të fermerëve.

Projektet në realizim në bashkëpunim me organizata:

- Care International në bashkëpunim me Komunën e Podujevës ka implementuar projektin “Avancimi dhe Përfshirja e Agrobizneseve të Grave në Kosovë (AKWA).”
Lidhur me këtë projekt ka qenë e hapur ftesa publike për aplikim nga data 11.02.2025 dhe do të jetë e hapur deri më 24.02.2025.
Në kuadër të këtij projekti janë përkrahur 35 fermere me këto pajisje:
 - Pajisje për bletari;
 - Pajisje për përpunimin e qumështit;
 - Motokultivatorë;
 - Serra 50m2.

AKTIVITETE TË TJERA QË REALIZOHEN NË KUADËR TË DBPZHR

- Kërkesa për regjistrimin me Numrin Identifikues të Fermerit (NIF);
- Monitorimi në terren i subvencioneve të ndara gjatë vitit 2024;
- Kërkesa për shndërrimin apo ndërrimin e destinimit të tokave;
- Kërkesa për subvencione;
- Kërkesa të ndryshme.

Numri i subvencioneve të akorduara gjatë vitit 2025

Viti 2025	Gra	Bura	Total
Projekti i mjedrave	3	7	10
Projekti i feferonave	4	11	15
Projekti i pemëtarisë	9	34	43
Projekti i mëshqerrave	52	110	162
Projekti i mekanizimit bujqësor	23	120	143
Projekti i shpezëtarisë	0	4	4

Podujevë

Nr. 12-401/04-0010655/26

Datë: 20.02.2026



Drejtor i DBPZHR

Beltram Latifi